



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

Shtator 2019

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Teto

Nentor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shtator 2019

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2019  
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Shtator 2019 arriti në 106.6 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Shtator 2019 ishte 1.3 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Shtator 2019 ishte 110.44 lekë për dollarë dhe 121.61 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Shtator 2019 shënuan kuotën 0.45 për qind për ato 12-mujore; 0.29 për qind për depozitat 6-mujore; 0.18 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.76 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.75 për qind për huatë 12-mujore dhe 7.0 për qind për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.296.204 milionë lekë në muajin Shtator, duke shënuar një rritje prej rreth 3.3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të 2019-ës shënoi rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën -43.6 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Shtator 2019 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth -3.3 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej -7.4 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar- Shtator 2019, arritën në rreth 343.859 miliardë lekë ose afërsisht 98% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 347.181 miliardë lekë ose rreth 97% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*


# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Shtator 2019 ishte +1.3%. Ndërsa, një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +2.1%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Shtator 2019 shënoi rritje prej 0.1 për qind krahasuar me muajin paraardhës. Gjithashtu në muajin Gusht shënoi rritje me 0.3 për qind, ndërsa në Korrik 2019 pësoi rënie prej -0.1 për qind krahasuar me muajin parardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Shtator 2018 shënoi rritje prej 0.2 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Shtator 2018, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2.5%, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1.5% secili, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1.2%, “Shërbimi arsimor” me 0.9%, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0.7%, “Argëtim e kulturë” me 0.5%, “Veshje dhe këpucë” me 0.2% etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 0.6%.



**Ndryshimi mujor i indeksit është 0.1%.** Krahasuar me muajin Gusht 2019, çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” u rritën me 0.6%, pasuar nga “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Argëtim dhe kulturë” me nga 0.4% secili, “Shërbimi arsimor” me 0.2%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë”, “Shëndeti” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0.1% secili. Ndërsa, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1.5%.

**Tab - 1** *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2018</b>	1.7	2.1	2.0	2.1	2.1	2.4	2.3	2.2	<b>2.1</b>	1.9	1.8	1.8
<b>2019</b>	1.9	1.7	1.1	1.4	1.5	1.3	1.5	1.5	<b>1.3</b>			


Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Shtator 2019, arriti në 121.61 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.29 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Shtator, një euro u këmbye me 122.11 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Shtator 2019 arriti në 110.44 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 1.34 për qind kundrejt muajit Gusht 2019. Në fund të muajit Shtator, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 111.7 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Shtator të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 3.84 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 1.86 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.



**Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Shtator 2019**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një rritje mesatare rreth 0.91 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Shtator 2019, normat e interesit të depozitave me afat 1 mujore dhe 12 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.76 dhe 0.45 për qind, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.29 dhe 0.18 për qind respektivisht.

Normat e interesit të depozitave 12, 6 dhe 1 mujore kanë shënuar rritje mujore prej përkatësisht 0.09, 0.06 dhe 0.32 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave 3 mujore kanë pësuar rënie me 0.05 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6 dhe 3 mujore, kanë pësuar rënie vjetore prej përkatësisht 0.19, 0.20 dhe 0.11 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave 1 mujore kanë shënuar rritje vjetore me 0.09 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit Shtator 2019 arritën përkatësisht kuotën prej 7.00 dhe 6.75 për qind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 1.02 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të huave 6 mujore kanë pësuar rënie prej 0.69 pikë përqindje. Duke krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje vjetore prej 0.58 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të huave 6 mujore kanë pësuar rënie vjetore me 0.16 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Shtator 2019 arritën nivelin 2.26 për qind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.21 për qind dhe rritje vjetore prej 0.59 për qind.

Fig. 3





Fig-4




## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2019 pësoi rënie të mjeteve valutore, me rreth 43.6 milionë euro. Tremujori i dytë i 2019-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 273 milionë euro. Në terma vjetorë, deficitin korrent u zgjerua me rreth 62%. Deficiti tregtar (mallra dhe shërbime) u zgjerua me rreth 21%, në nivelin 519 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 261 milionë euro, në zgjerim me rreth 114 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë. Fluksi hyrës neto në llogarinë financiare prej 307 milionë euro, në zgjerim me rreth 8% në terma vjetore, mbulon plotësisht deficitin korrent.

Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.


Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve korrente shënon 3,203 milionë euro, në rritje me rreth 7% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në 273 milionë euro, rreth 62% më i lartë krahasuar me një vit më parë. Thellimi i deficitit korrent, reflekton zgjerimin e deficitit tregtar në mallra dhe balancës negative të të ardhurave parësore nga investimet. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e dytë 2019 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -781.6 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 262.7 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -2.9 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 248.6 milionë euro.



**Bilanci i Pagesave per T2 - 2019**

Burimi: Banka e Shqipërisë



**Llogaria Korente per T2 - 2019**

Burimi: Banka e Shqipërisë



## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar


Gjatë muajit Shtator 2019, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 20.792 milionë lekë krahasuar me muajin Shtator të vitit 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto bankës qendrore me 29.068 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 2.113 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 9.245 milionë lekë e bankës qendrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1.296.204 milionë lekë në muajin Shtator 2019, duke shënuar rritje prej rreth 41.912 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.3 për qind.

Në muajin Shtator 2019, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 2.471 milionë lekë ose -0.2 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.


Fig-7



Ecuria e M.V.N. të sistemit në Shtator '18 - Shtator '19

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-8



Agregati M3 Shtator '18 - Shtator '19



Burimi: Banka e Shqipërisë

## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Shtator 2019 arriti në rreth 565.625 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 30.548 milionë lekë, ose rritje me rreth 5.71 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (51.2%) dhe monedhave të huaja (48.8%).

Gjatë muajit Shtator 2019, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 59.2 për qind ose 335.068 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.38 për qind ose 194.446 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.94 dhe 2.34 për qind apo 22.299 dhe 13.223 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Shtator 2019, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.37 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 23.83 për qind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.30 për qind dhe rreth 1.51 për qind.



## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 284.249 milionë lekë në fund të muajit Shtator 2019. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Shtator 2019 ka pësuar rënie mujore prej 0.28 për qind, si dhe rritje vjetore prej 0.50 për qind, duke arritur nivelin 21.9 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka pësuar gjithashtu rënie mujore prej 0.45 për qind dhe rritje vjetore prej 0.82 për qind, duke shënuar nivelin 28.1 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Shtator 2019, kanë shënuar rritje vjetore prej 24.406 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.3 për qind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Shtator 2019 shënuan rritje prej 2.043 milionë lekë në krahasim me muajin Shtator 2018. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.5 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Shtator 2019, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.5 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 13.0 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.6 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.3 për qind dhe rreth 17.1 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.3 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 822.600 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (154.037 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (17.950 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (15.801 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.565 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Shtator 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Shtator 2019, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.011.955 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 1.658 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 26.451 milionë lekë.


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Shtator 2019 janë mbledhur rreth 343.859 miliardë lekë të ardhura, përkundërt shpenzimeve të përgjithshme prej 347.181 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 304.451 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 42.677 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 30% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 231.377 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 18.998 miliardë lekë (ose rreth 115% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 72.247 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jokatimore në nivelin 17.167 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit për periudhën Janar-Shtator 2019).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 304.451 miliardë lekë, 57.241 miliardë lekë (19% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 25.394 miliardë



lekë (8%) për shpenzime interesi, 32.009 miliardë leke (11%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 787 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 126.571 miliardë lekë (41.6%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 42.432 miliardë lekë (14%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 18.353 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 71% (shpenzime personeli), 61% (shpenzime për interesat), 68% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 53% (subvencione), 71% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 83% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 76% (shpenzimet e tjera) përkundërt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 51%, ndërsa financimi i huaj është 40% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Shtator 2019 ishin rreth 343.859 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 323.399 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 17.167 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Shtator 2019 (mld Lekë) Revenues during September 2019 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Shtator '19 September '19	Shtator '18 September '18	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	10.17	12.02	-15.32
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.47	0.46	2.34
	Akcizat (Excise)	3.78	3.60	5.08
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	2.58	2.64	-2.19
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	5.73	2.81	104.0
	Taksat nacionale (National Tax)	2.55	3.10	-17.73

*Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Shtator – 2019*

*Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: September – 2019*

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 3.32 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Shtator 2019, u financua kryesisht nga huamarrjen e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe nga huaja afatgjatë e huaj.

Për muajin Shtator 2019, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 37.930 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 37.676 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Shtator 2019, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 34.9 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 33.2 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 4.4 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	
Janar	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	January
Shkurt	2.4	1.1	0.5	0.8	0.6	1.9	1.0	1.0	1.0	1.1	2.3	0.2	2.2	2.1	1.7	February
Mars	0.4	0.5	0.4	0.3	-0.3	1.4	0.8	0.8	0.9	0.6	2.2	0.3	2.1	2.0	1.1	March
Prill	-0.5	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	0.9	0.5	0.5	0.5	0.4	2.3	0.3	1.9	2.1	1.4	April
Maj	-1.6	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	0.2	0.2	0.1	0.2	0.1	1.8	0.7	2.0	2.1	1.5	May
Qershor	-1.1	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	0.1	0.04	0.0	0.1	0.1	1.4	1.2	2.2	2.4	1.3	June
Korrik	-0.7	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	0.1	0.15	0.0	0.1	0.0	1.3	1.9	2.0	2.3	1.5	July
Gusht	0.8	0.9	0.4	0.4	0.3	0.1	0.17	0.1	0.1	0.1	1.9	2.0	1.6	2.2	1.5	August
<b>Shtator</b>	0.6	0.4	0.4	0.2	<b>0.1</b>	0.2	0.17	0.1	0.1	<b>0.1</b>	2.2	1.8	1.6	2.1	<b>1.3</b>	<b>September</b>
Tetor	0.0	-0.2	0.0	-0.2		0.1	0.13	0.1	0.1		2.1	1.5	1.9	1.9		October
Nëntor	-0.3	0.1	-0.1	-0.2		0.1	0.12	0.1	0.1		2.1	1.9	1.7	1.8		November
Dhjetor	0.6	0.9	1.0	1.1		0.17	0.19	0.2	0.2		2.0	2.2	1.8	1.8		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit  
Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019									Currency		
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator			
					January	February	March	April	May	June	July	August	September			
<i>Mesatarja e periudhës</i>																<i>Average of period</i>
USD	126.64	128.29	112.56	108.43	108.92	109.73	110.53	110.57	109.96	108.02	108.62	108.98	110.44			USD
EURO	137.65	135.27	133.25	123.45	124.39	124.56	124.99	124.34	122.99	122.00	121.95	121.26	121.61			EURO
<i>Fundi i periudhës</i>																<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.58	110.51	111.67	110.09	109.97	107.69	109.07	110.59	111.70			USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	124.64	125.92	125.34	123.38	122.63	122.65	121.64	122.12	122.11			EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2015	2016	2017	2018	2019										In percent
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September		
<b>Norma e depozitave</b>															Deposits rates
12-M	1.27	0.78	0.80	0.75	0.73	0.68	0.57	0.48	0.43	0.41	0.40	0.36	0.45	0.45	12-M
6-M	1.17	0.78	0.56	0.56	0.45	0.45	0.56	0.52	0.42	0.37	0.26	0.23	0.29	0.29	6-M
3-M	0.54	0.27	0.29	0.30	0.24	0.25	0.31	0.18	0.19	0.16	0.20	0.23	0.18	0.18	3-M
1-M	0.88	0.87	0.82	0.62	0.65	0.71	0.55	0.62	0.53	0.80	0.73	0.44	0.76	0.76	1-M
<b>Norma e huasë</b>															Lending rates
12-M	7.47	4.54	6.79	6.34	6.76	5.89	5.89	6.23	6.55	5.39	6.25	5.73	6.75	6.75	12-M
6-M	8.35	7.01	8.12	8.16	7.63	7.50	7.69	6.87	9.67	6.70	6.31	7.69	7.00	7.00	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>															Securities rates
Bono thesari 1/															Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	2.46	2.00	-	-	-	1.07	-	0.85	0.96	-	-	1.48	-	-	6-M
12-M	2.40	2.92	2.63	1.43	1.33	1.25	1.14	1.11	1.29	1.57	1.81	2.05	2.26	2.26	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



## TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2019

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>34,675</b>	<b>68,862</b>	<b>108,222</b>	<b>149,290</b>	<b>188,464</b>	<b>226,116</b>	<b>265,798</b>	<b>305,929</b>	<b>343,859</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>387</b>	<b>598</b>	<b>793</b>	<b>1,147</b>	<b>1,355</b>	<b>2,036</b>	<b>2,550</b>	<b>2,754</b>	<b>3,293</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>33,030</b>	<b>64,590</b>	<b>101,552</b>	<b>140,451</b>	<b>176,918</b>	<b>212,212</b>	<b>249,804</b>	<b>288,463</b>	<b>323,399</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>22,638</b>	<b>44,928</b>	<b>72,773</b>	<b>97,755</b>	<b>124,713</b>	<b>150,364</b>	<b>176,925</b>	<b>205,798</b>	<b>231,377</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,971	21,550	32,380	43,518	54,961	65,913	78,471	90,539	100,728	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,613	4,049	11,651	15,272	17,696	20,444	22,544	24,587	27,173	Profit Tax
3	Akcizat	2,900	6,025	9,863	13,230	16,982	21,254	26,057	31,103	34,891	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,677	6,593	9,376	12,651	18,440	22,129	26,033	31,653	37,392	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,068	5,871	8,092	11,118	14,076	17,508	20,074	23,589	26,389	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	410	840	1,411	1,966	2,558	3,117	3,747	4,326	4,804	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,353</b>	<b>3,173</b>	<b>4,909</b>	<b>9,627</b>	<b>11,348</b>	<b>13,458</b>	<b>15,180</b>	<b>17,255</b>	<b>18,998</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	221	431	817	2,279	2,665	3,123	3,470	3,820	4,194	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	1	5	27	252	282	301	311	321	328	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,131	2,737	4,066	7,096	8,401	10,034	11,399	13,114	14,477	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>9,038</b>	<b>16,488</b>	<b>23,870</b>	<b>33,069</b>	<b>40,856</b>	<b>48,389</b>	<b>57,699</b>	<b>65,409</b>	<b>73,023</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	7,711	14,067	20,421	28,194	34,918	41,410	49,329	55,984	62,543	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	1,271	2,213	3,167	4,454	5,456	6,424	7,731	8,721	9,703	Health insurance
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>1,258</b>	<b>3,674</b>	<b>5,876</b>	<b>7,692</b>	<b>10,191</b>	<b>11,867</b>	<b>13,444</b>	<b>14,713</b>	<b>17,167</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			576	576	576	576	576	576	576	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	712	2,622	3,842	5,091	6,823	7,867	8,894	9,638	11,522	Income of budgetary institutions
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>32,445</b>	<b>67,578</b>	<b>104,591</b>	<b>146,268</b>	<b>188,063</b>	<b>229,569</b>	<b>271,977</b>	<b>309,505</b>	<b>347,181</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>28,971</b>	<b>61,789</b>	<b>95,344</b>	<b>129,973</b>	<b>165,834</b>	<b>200,108</b>	<b>237,554</b>	<b>271,250</b>	<b>304,451</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>5,949</b>	<b>12,034</b>	<b>18,305</b>	<b>24,484</b>	<b>31,065</b>	<b>37,690</b>	<b>44,415</b>	<b>50,890</b>	<b>57,241</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	5,100	10,315	15,679	20,991	26,629	32,320	38,008	43,477	48,918	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	844	1,693	2,570	3,419	4,337	5,246	6,141	7,013	7,881	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>4,047</b>	<b>6,750</b>	<b>9,525</b>	<b>12,029</b>	<b>14,126</b>	<b>16,418</b>	<b>20,429</b>	<b>22,777</b>	<b>25,394</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	2,846	4,922	6,977	8,836	10,442	12,214	15,053	16,789	18,569	Domestic
2	Të Huaja	1,200	1,828	2,547	3,193	3,685	4,204	5,377	5,988	6,825	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>2,487</b>	<b>5,478</b>	<b>9,028</b>	<b>13,835</b>	<b>18,123</b>	<b>21,602</b>	<b>25,464</b>	<b>28,576</b>	<b>32,009</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveconet</b>	<b>74</b>	<b>203</b>	<b>359</b>	<b>430</b>	<b>489</b>	<b>546</b>	<b>601</b>	<b>682</b>	<b>787</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>12,387</b>	<b>25,873</b>	<b>40,017</b>	<b>53,663</b>	<b>68,063</b>	<b>82,876</b>	<b>97,840</b>	<b>113,440</b>	<b>128,234</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	9,547	19,193	29,265	39,652	50,440	61,496	72,807	84,780	95,896	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	2,376	5,890	9,963	13,097	16,512	20,102	23,571	27,198	30,676	Health insurance
I.6	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>2,701</b>	<b>8,097</b>	<b>12,669</b>	<b>17,966</b>	<b>24,071</b>	<b>29,158</b>	<b>34,816</b>	<b>38,463</b>	<b>42,432</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,327</b>	<b>3,354</b>	<b>5,441</b>	<b>7,566</b>	<b>9,896</b>	<b>11,818</b>	<b>13,988</b>	<b>16,422</b>	<b>18,353</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	33	76	130	180	225	272	313	352	389	Unemployment insurance benefits
I.8	<b>Transferime Kapitale</b>				35	37	37	37	53	53	
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>3,474</b>	<b>5,782</b>	<b>9,241</b>	<b>16,253</b>	<b>22,198</b>	<b>29,424</b>	<b>34,385</b>	<b>38,201</b>	<b>42,677</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	2,583	3,237	6,027	11,250	15,950	21,125	24,118	26,852	29,211	Domestically financing
2	Financimi Huaj	886	2,496	3,145	4,847	5,949	7,909	9,784	10,845	12,939	Foreign financed
IV	<b>Detyrimet e prapambetua</b>										<b>Arrears</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>2,230</b>	<b>1,284</b>	<b>3,630</b>	<b>3,023</b>	<b>400</b>	<b>-3,453</b>	<b>-6,177</b>	<b>-3,575</b>	<b>-3,322</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-2,230</b>	<b>-1,284</b>	<b>-3,630</b>	<b>-3,023</b>	<b>-400</b>	<b>3,453</b>	<b>6,177</b>	<b>3,575</b>	<b>3,322</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-1,502</b>	<b>-2,473</b>	<b>-3,348</b>	<b>1,828</b>	<b>4,534</b>	<b>9,840</b>	<b>15,124</b>	<b>13,045</b>	<b>13,025</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	29	34	47	67	76	79	100	102	152	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-5,900	-7,329	-2,600	799	2,733	5,226	7,060	6,638	10,223	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	4,369	4,823	-795	961	1,726	4,536	7,964	6,305	2,649	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>-728</b>	<b>1,189</b>	<b>-283</b>	<b>-4,850</b>	<b>-4,935</b>	<b>-6,387</b>	<b>-8,947</b>	<b>-9,469</b>	<b>-9,703</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë (e marrë)	1,403	2,488	2,919	4,268	6,385	8,338	9,467	10,025	11,579	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	222	291	447	491	979	1,138	1,556	1,632	1,838	Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-804	-445	-250	-206	-982	-1,650	-1,414	-1,120	-1,013	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,327	-2,254	-4,352	-10,313	-11,737	-14,475	-18,400	-20,018	-21,912	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	-	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,643	1,643	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

## Tabela e investimeve 2019

Table of investments 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in m

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	
<b>Financim i brendshëm</b>	- 1,502	- 2,473	- 3,348	1,828	4,534	9,840	15,124	13,045	13,025	<b>Domestic financing</b>
Në %	67.4	192.59	92.2	-60.46	-1133.56	284.95	244.83	364.84	83.10	In %
<b>Financim i huaj</b>	- 728	1,189	- 283	- 4,850	- 4,935	- 6,387	- 8,947	- 9,469	2,649	<b>Foreign financing</b>
Në %	32.6	-92.59	7.8	160.46	1233.56	-184.95	-144.83	-264.84	16.90	In %
<b>Totali</b>	<b>-2,230</b>	<b>-1,284</b>	<b>-3,630</b>	<b>-3,023</b>	<b>-400</b>	<b>3,453</b>	<b>6,177</b>	<b>3,575</b>	<b>15,674</b>	<b>Total</b>
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finar

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2019**  
**CUSTOMS REVENUES 2019**

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million Lek)*

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	
Taksë doganore	410	840	1,411	1,966	2,558	3,117	3,747	4,326	4,804	Customs Duties
TVSH	6,893	14,742	23,426	32,766	42,243	51,098	61,293	71,082	79,405	V.A.T
Akcizë	2,900	6,025	9,862	13,229	16,982	21,254	26,056	31,103	34,891	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	201	356	532	731	1,017	1,180	1,358	1,506	1,754	Others (Mineral Rent)
